



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: PRANUAR/DORZUAR: 10-10-2024			
DATE: PRILJEN/DOSTAVLJEN: 10-10-2024			
DATE: RECEIVED/SUBMITTED: 10-10-2024			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
01	410	1577	4



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY

MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

në mes të

ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT

dhe

AGJENCISË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI

Prishtinë, 10 tetor 2024



Zyra Kombëtare e Auditimit – me adresë në: Prishtinë, Rr “Ahmet Krasniqi” Nr. 210, përfaqësuar nga **Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme** (në tekstin e mëtejme referuar si **ZKA**); dhe

Agjencia për Informim dhe Privatësi, me adresë në Prishtinë, Rr. “Zeinel Salihu” Nr. 22, përfaqësuar nga **Krenare Sogojeva Dërmaku, Komisionere për Informim dhe Privatësi** (në tekstin në vazhdim “AIP”);

Të vendosura për forcimin dhe zbatimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës në pajtim me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e inspektimit, kontrolleve dhe auditimeve të sistemeve të informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave personale;

Duke konsideruar të rëndësishëm forcimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet dy institucioneve, bazuar në mandatin dhe përgjegjësitë e tyre, me qëllim që të avancojnë dhe nxisin shkëmbimin e informacioneve përkatëse, si dhe

Duke marrë parasysh se rritja e vazhdueshme e përdorimit të sistemeve të informacionit nga institucionet publike për qëllime të digjitalizimit të shërbimeve, shton nevojën për rritjen e auditimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përmes inspektimeve dhe kontrolleve nga Agjencia për Informim dhe Privatësi;

Lidhin këtë:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i Marrëveshjes është ngritja e nivelit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe arritjes së qëllimeve të institucioneve në përputhje me legjislacionin kombëtar,



Neni 2

Fushëveprimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, palët do të bashkëpunojnë në fushat e përgjegjësisive të tyre kushtetuese e ligjore.

Neni 3

Përgjegjësitë

1. Palët do të koordinojnë aktivitetet e përbashkëta në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike dhe zbatimin e tyre në praktikë.
2. ZKA do t'i ofrojë mbështetje AIP-së përmes trajnimeve në ngritjen e kapaciteteve profesionale lidhur me sigurinë e sistemeve të informacioneve në mbrojtjen e të dhënave personale.
3. AIP do t'i ofrojë mbështetje ZKA-së përmes trajnimeve në ngritjen e kapaciteteve profesionale që ndërlidhen me Qasjen në Dokumente Publike dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.
4. Shkëmbimi i përvojave dhe informacioneve mbi praktikat më të mira në auditim dhe inspektim të sistemeve të informacionit.
5. Përmirësimi i sigurisë së sistemeve të informacioneve dhe mbrojtjen e të dhënave personale përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rekomandimeve.

Neni 4

Koordinimi dhe komunikimi ndërmjet palëve

1. Palët zotohen se do të krijojnë kanalin e komunikimit përmes të cilit do të shkëmbehen të dhënat të cilat janë të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshje. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët do të emërojnë nga një zyrtar përgjegjës.
2. Palët do të organizojnë edhe takime të rregullta periodike.

Neni 5



Konfidencialiteti dhe pavarësia institucionale

1. Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje, të gjitha të dhënat e shkëmbyera ndërmjet Palëve nënshkruese do të konsiderohen konfidenciale dhe do të menaxhohen nga persona të emëruar nga Palët, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe me ligj.
2. Informatat dhe dokumentet të cilat janë pranuar brenda kornizës së kësaj Marrëveshjeje, nuk do të përdoren, publikohen ose shpërndahen nga Palët për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara me këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe me ligj.

Neni 6


Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi derisa Palët nuk vendosin ndryshe.
2. Marrëveshja mund amendamentohet nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
3. Kjo Marrëveshje është hartuar dhe nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale, nga dy (2) kopje origjinale për secilën Palë.

Kjo Marrëveshje u nënshkrua në Prishtinë, më datë 10 korrik 2024.

Në emër të ZKA:

Vlora Spanca



Auditore e Përgjithshme

Në emër të AIP:

Krenare Sogojeva Dermaku



Komisionere për Informim dhe Privatësi